




Një kuadër rregullator për përcaktimin, testimin dhe monitorimin e cilësisë së ngrohësve me biomasë nuk është i zhvilluar në vendet e Ballkanit Perëndimor. Pjesa më e madhe e ngrohësve me biomasë që ndodhen në treg nuk i janë nënshtruar testimit të përcaktuar nga standardet e EN. Cilësia e ajrit, shëndeti njerëzor, mbrojtja e burimeve natyrore dhe zhvillimin i tregut të qëndrueshëm të pajisjeve ngrohëse me biomase kërkojnë një politikë që inkurajon prodhimin dhe shitjen e pajisjeve ngrohëse me biomasë të sigurta dhe të pastra.

Vendet e Ballkanit Perëndimor mund të zgjedhin që të përdorin standarde ndërkombëtare për pajisjet ngrohëse me biomasë ose të zhvillojnë standardet e tyre kombëtare.

Aplikimi i standardeve teknike është vullnetar, dhe si i tillë nuk vendos rregulla. Gjithsesi, ligjet kombëtare dhe rregulloret mund të preferojnë t'i referohen standardeve teknike dhe madje të kërkojnë pajtueshmëri të detyrueshme me ta. Nëse produktet (p.sh. ngrohësit me biomasë) rregullohen me standarde teknike të detyrueshme dhe ato nuk i plotësojnë këto standarde-ato nuk mund të futen në treg.

BE ka zhvilluar një kuadër gjithëpërfshirës rregullator me standarde teknike për lloje të ndryshe të pajisjeve ngrohëse të biomasës. (Figura 1)

	<p>Për të siguruar qasje formale të marketingut dhe të shitjeve të pajisjeve ngrohëse të biomasës në tregun European, të gjitha pajisjet ngrohëse duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE dhe kërkesat e sigurisë, shëndetësisë dhe mjedisit – edhe gjatë prodhimit dhe si produkt përfundimtar. Etiketa CE-është një dëshmi e këtij konformiteti.</p>
---	--

Për të marrë etiketën CE, pajisjet e ngrohësve me biomasë duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve teknike të mëposhtme:

- EN 13229 Pajisjet e brendshme duke përfshirë dhe zjarret e hapura të shkaktuara nga lëndët djegëse të ngurta

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans



- EN 13240 Ngohësit e dhomave që ndizen me lëndë djegëse solide
- EN 14785 Pajisjet ngrohëse të banesave që ndizen me peleta
- EN 12809 Bojlerët e pavarur të banesave që ndizen nga lëndë solide
- EN 12815 Soba për banesa që ndizen nga lëndë djegëse solide

Për shembull, etiketimi CE për sobat me dru jepet në bazë të testimit sipas standardeve Europiane EN13240 dhe do të thotë që efikasiteti i sobave me dru është të paktën 50%.

Direktiva e ekodizanj (2009/125/EC) dhe Direktiva e Etiketimit të Energjisë (2010/30/EC) përcaktojnë kornizën për kërkesën për produktet e lidhura me energji për t'u vendosur në tregun Europian. Standardet aktuale teknike që pajisjet e ngrohjes me biomasë janë të përcaktuara në rregulloret specifike të zbatueshme për kategoritë e produkteve individuale. Për pajisjet e ngrohjes me biomasë-druri, dy kategori produktesh janë relevante:

- Lot 15 - kaldaja me lëndë djegëse të ngurta me një nxehtësi të vlerësuar prej 500 kW ose më pak
- Lot 20 - Ngrohëset lokale me lëndë djegëse të ngurta me një nxehtësi nominale prej 50 kW ose më pak.

Direktiva Ekodizajn vendos limite për emëtimet dhe efikasitetin e tyre dhe ndihmon në eliminimin e produkteve më pak të realizueshme nga tregu, duke kontribuar në objektivin e efijencës së energjisë 2020. (Figura 2)

<p>The diagram shows an energy label with a scale from A++ (green) to G (red). Below the scale are two sections: one for heating (indicated by a house icon and a radiator) and one for hot water (indicated by a water tap icon and a radiator), both with a power rating of XY,Z kW. The label also features the EU flag, the word 'ENERG' in multiple languages, and the number 2015/1186.</p>	<p>Në BE, nga 1 Janari i 2018 pajisjet e ngrohësve me lëndë solide (<50kW) duhet të shiten me një etiketë të printuar që tregon prodhimin e nxehtësisë dhe indeksin e efijencës së energjisë. Përveç kësaj, çdo informacion promovues duhet të përfshijë referencën në klasën e efikasitetit - në një shkallë nga A++ (më efikase) te G (më pak efikase).</p> <p>Nga 1 Janari i 2022, përveç etiketës, Rregulloret e Ekodizajnit përcaktojnë një paketë të limiteve të emetimeve të cilat duhet të përmbushen- duke përfshirë grimcat, monoksidet e karbonit (CO), oksidet e azotit (NOx) dhe Komponentët e Gazrave Organike (OGC). Efijenca minimale sezonale e ngrohjes së hapësirës do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> 30% për ngrohësit e ambientit të hapur në pjesën e përparme 65% për ngrohësit e ambientit të mbyllur në pjesën e përparme(jo me peleta) 79% për ngrohësit e mbyllur në pjesën përpara (me peleta) 65% për sobat
---	---

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans



Zbatimi i rregulloreve të reja do të kryhet nga Autoritetet Kombëtare të Mbikqyrjes së Tregut (MSAs).

Metoda e vlerësimit që përcakton efikasitetin dhe emetimet e pajisjeve për ngrohjen e biomasës përcaktohet nga standarti teknik EN 303-5 për kaldaja me ngrohje manuale dhe automatike për lëndët e ngurta me një nxehtësi nominale deri në 500 kW.

Testimi i pajisjes për ngrohje të biomasës sipas standardit EN 303-5 mund të kryhet vetëm nga subjektet testuese të certifikuara nga organizmat e akreditimit. Konformiteti me parametrat konfirmohet nga një certifikatë e lëshuar nga një njësi e tillë testimi e akredituar.

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans

